



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2023, të miratojë këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I.MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej 29.918.00 € (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë euro), konform Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023, përkatësisht ;

- a. 23,332,00 euro (njëzet e tremijë e treqind e tridhjetë e dy euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit me serra bujqësore si dhe

- b. 6,586.00 euro (gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit me mekanizëm bujqësor (frezë për traktor, kosë për traktorë) si dhe në fushën e blegtorisë (lope qumështore dhe kope delesh).

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës , kodi i programit 47003, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim- Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura ligjore dhe me qëllim të përkrahjes familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit për sigurimin e serrave bujqësore, mekanizëm bujqësorë dhe në fushën e blegtorisë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-18799
Lipjan, më 14.04.2023

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti



Pranuar më: Priljeno: 10.05.2022		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shitja Dodatak
1-400/01-	23123	



Në mbështetje të Nenit 5 pika d), Nenit 58 pika a), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Statutin e Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24/12/2021, palët nënshkruese, më 10/05/2022 lidhin këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI DHE BASHKËFINANCIMI NË MES TË

I. Organizatës "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori z. Esam Dabab, tutje referuar si pala e parë; dhe:

II. Komunës së Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari z. Imri Ahmeti, tutje referuar si pala e dytë.

Neni 1

Objekti i Memorandumit

Objekt i këtij memorandumi është ndarja e granteve (serrave për kultivim) për familjet me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Obligimet e palës së parë

1. Pala e parë Organizata Qatar Charity merr përsipër 70% të vlerës në emër të shpenzimit direkt për vlerën totale të realizimit të këtij projekti.
2. Përzgjedhja e kompanive për realizimin e granteve.
3. Kontraktimi me kompanitë realizuese dhe përfituesve të granteve.

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

1. Pala e dytë, participon me pjesën prej 30% nga vlera e shpenzimit direkt (financimit të palës së parë), të cilat ndër të tjera përfshijnë participimin për shpenzime administrative dhe teknike.
2. Pala e dytë detyrohet që brenda (2) javëve pas nënshkrimit të aneks kontratës, këto mjete t'i transferojë në xhirollogarinë e organizatës "Qatar Charity", në Bankën NLB dhe numrin e llogarisë 1701001600054596, në përputhje me aneks-kontratën e cila do të nënshkruhet pas kësaj kontrate dhe e cila do ta plotësojë këtë kontratë me specifikacionet si: numri i granteve dhe vlera e tyre etj.
3. Pala e dytë, obligohet që participimin sipas paragrafit 1, ta dëshmojë me anë të fletëdëshmisë së transferimit të këtyre mjeteve, brenda afatit të lartcekur në paragrafin 2 të këtij Neni.
4. Pala e dytë, duhet të sigurojë mjetin transportues për realizimin e vizitave dhe kontaktimit me aplikuesit gjatë vizitës.
5. Pala e dytë, ka për obligim dërgimin e listës së aplikuesve për grante të printuar si dhe në formatin excel.

Listës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente për secilin rast të propozuar, si:

- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata Themelore përkatëse, që dëshmon se ndaj aplikuesit nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale;
- Certifikatën e Bashkësisë Familjare; dhe
- Konfirmimin e te ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i papunë).

Të gjitha këto obligime duhet të përfundojnë më së largu pesë (5) ditë pune që nga data e mbylljes së afatit për aplikim.

Neni 4 *Obligimet e ndërsjella*

1. Procedurat dhe kontaktet zyrtare deri në realizimin e projektit janë plotësuese të këtij memorandumi. Procedurat janë si në vijim:

- Caktimi i personave kontaktues, dhe të autorizuar për zhvillimin e procedurave të nevojshme;
- Vizitat e të propozuarve prej të dyja palëve (përfaqësuesi i organizatës dhe përfaqësuesit e Komunës);
- Përzgjedhja e përfituesve kryhet nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga zyrtarë të Qatar Charity si dhe pjesë e tij do të jenë edhe përfaqësues të Komunës së Lipjanit, në pajtim me Rregulloren e Qatar Charity me të cilën përcaktohen kushtet për përzgjedhjen e përfituesve, duke i përmbushur kriteret kryesore për secilën familje si:
1) Kushtet e rënda ekonomike; 2) Mundësia e realizimit të grantit; dhe 3) Përfituesi i grantit të mos jetë duke u hetuar/i dënuar për vepër penale.
- Hartimi i raportit pas përfundimit të realizimit të projektit.

2. Palët nënshkruese, dakordohen se do të bëhet hartimi i një aneks kontrate me anë të së cilës do të ceket **numri i granteve dhe vlera e tyre**. Kjo aneks kontratë do të definohet pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara me këtë Memorandum dhe e njëjta do të konsiderohet pjesë përbërse e këtij Memorandumi.

Neni 5 *Afati i përmbushjes*

Palët nënshkruese pajtohen që pranimi teknik të realizohet prej të dy palëve nënshkruese dhe finalizimi i projektit do të bëhet më së largu deri më datën 31/12/2022.

Neni 6 *Të drejtat e ndërsjella*

Të dy palët mbajnë të drejtën e inspektimit-vizitës pa paralajmërim të përfituesit, fotografimin apo zhvillimin e intervistës me përfituesin, me qëllim që të binden për arritjen e qëllimit të projektit.

Neni 7

Parimet e përgjithshme mbi të cilat funksionon Qatar Charity me palë të treta

Palët nënshkruese pajtohen për respektimin e parimeve, por pa u kufizuar në:

- Respektimin e të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të marginalizuara dhe mos lejimi i ndonjë pale të shfrytëzojë ato apo të shkelë të drejtat e tyre;
- Respektimin e parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit;
- Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare;
- Respektimi i ligjit dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndalimin e pastrimit të parasë, apo ndalimit të financimit të terrorizmit.

Neni 8

Zgjidhja e paqartësive

Palët nënshkruese pajtohen që në rast të ndonjë paqartësie eventuale në mes palëve nënshkruese sa i përket realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi, zgjidhja të bëhet me mirëbesim dhe biseda të ndërsjella mes tyre.

Neni 9


Hyrja në fuqi

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje.

PALËT NË MARRËVESHJE

Drejtor i organizatës "Qatar Charity"


z. Esam Dabab



قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Kryetar i Komunës së Lipjanit

z. Imri Ahmeti



Në mbështetje të Nenit 5 pika d), Nenit 58 pika a), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Statutin e Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24/12/2021, palët nënshkruese, më 24/11/2022 lidhin këtë:

ANEKS MARRËVESHJE

I. Organizatës “QATAR CHARITY” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori **z. Esam Dabab**, tutje referuar si **pala e parë**; dhe:

II. Komunës së Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari **z. Imri Ahmeti**, tutje referuar si **pala e dytë**.

Neni 1

Objekti i Aneks Marrëveshjes

Objekt i kësaj Aneks Marrëveshje është plotësimi i “MEMORANDUM BASHKËPUNIMI DHE BASHKËFINANCIMI” të nënshkruar nga ana e palëve të lartëcekura me datë: 10/05/2022 dhe me numër të protokollit 1-400/01-23123 i cili ka për qëllim ndarjen e pesëdhjetë (50) serrave bujqësore për kultivim me sipërfaqe 96m², nga ana e Organizatës “QATAR CHARITY” në bashkëpunim dhe bashkëfinansim me palën e dytë Komunën e Lipjanit.

Vlera totale për realizmin e projektit të lartëcekur është 77,776.0 EUR (shtatëdhjetëeshtatë mijë e shtatëqinde shtatëdhjetë e gjashtë euro).

Neni 2

Obligimet e palës së parë

Pala e parë Organizata “QATAR CHARITY” merr përsipër financimin e 70% të vlerës në emër të shpenzimit direkt për vlerën totale të realizimit të këtij projekti: furnizimi dhe montimi i pesëdhjetë (50) serrave bujqësore për kultivim me sipërfaqe 96m² si dhe shpenzimeve të tjera të cilat ndërlidhen me realizmin e projektit me vlerë: 54,443.00 EUR (pesëdhjetëekatërmijë e katërqindëkatërdhjetë euro).

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

Pala e dytë, participon me pjesën prej 30% nga vlera e shpenzimit direkt (financimit të palës së parë), për vlerën totale të realizimit të këtij projekti: furnizimi dhe montimi i pesëdhjetë (50) serrave bujqësore për kultivim me sipërfaqe 96m² si dhe shpenzimeve të tjera të cilat ndërlidhen me realizmin e projektit me vlerë: 23,332.00 EUR (njëzetetremijë e treqindetridhjetë euro).

Pala e dytë obligohet që brenda dy (2) javëve pas nënshkrimit të aneks marrëveshjes, këto mjete t’i transferojë në xhirollogarinë e Organizatës “Qatar Charity”, në Bankën NLB dhe numrin e llogarisë **1701001600054596**.

Kësaj aneks marrëveshje iu bashkëngjitet tabela e shpenzimeve e detajuar.

Ky aneks i marrëveshjes hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe i njëjti nënshkruhet në dy (2) kopje identike, prej të cilave secila palë mban nga një (1) kopje.

Nënshkruajnë:

Drejtor i organizatës “Qatar Charity”
z. Esam Dabab/



Rr. Abdyl Frashëri nr.39 – 10,000 Prishtinë - Kosovë

Kryetar i Komunës së Lipjanit
z. Imri Ahmeti



Tel: 00383/38 243 935, e-mail: qckosovo@qcharity.org

Tabela e shpenzimeve për realizmin e projektit të shpërndarjes së 50 serrave për kultivim në Komunën e Lipjanit

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Vlera për njësi	Vlera në EURO	Vlera në %
1	Serrë bujqësore për kultivim 96 m ²	50	copë	1,420.0	71,000.00	91.3%
2	Angazhimi I stafit	6	muaj	600.0	3,600.00	4.6%
3	Realizimi I trajnimeve për përfitues	2	ditë	600.0	1,200.00	1.5%
4	Transporti për realizmin e projektit	6	muaj	170.0	1,020.00	1.3%
6	Shpenzime administrative	1	//	450.0	450.00	0.6%
7	Realizimi I ceremonis përmbyllëse të projektit	1	ditë	406.0	406.00	0.5%
9	Realizimi I vizitave zyrtare	1	//	100.0	100.00	0.1%
Shpenzime total					77,776.00	100.0%
Vlera e financimit nga ana e palës së parë Organizatës "Qatar Charity"					54,443.00	70%
Vlera e bashkëfinancimit nga ana e palës së dytë Komuna e Lipjanit					23,332.00	30%

Organizata Qatar Charity
z. Esam Dabab

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Komuna e Lipjanit
z. Imri Ahmeti



Në mbështetje të Nenit 5 pika d), Nenit 58 pika a), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Statutin e Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24/12/2021, palët nënshkruese, më 13/04/2023 lidhin këtë:

ANEKS MARRËVESHJE

I. Organizatës “QATAR CHARITY” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori z. Esam Dabab, tutje referuar si pala e parë; dhe:

II. Komunës së Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari z. Imri Ahmeti, tutje referuar si pala e dytë.

Neni 1

Objekti i Aneks Marrëveshjes

Objekt i kësaj Aneks Marrëveshje është plotësimi i “MEMORANDUM BASHKËPUNIMI DHE BASHKËFINANCIMI” të nënshkruar nga ana e palëve të lartëcekura me datë: 31/08/2022 dhe me numër të protokollit 1-660/03-47252 i cili ka për qëllim shpërndarjen e mekanizmit bujqësorë (34 – tridhjetë e katër frezë për traktor, 12 – dymbëdhjetë kosë për traktor) si dhe në fushën e blegtorisë (7 – shtatë lopë qumështore, 5 – pesë kope delesh) për familjet me kushte të rënda ekonomike, nga ana e Organizatës “QATAR CHARITY” në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me palën e dytë Komunën e Lipjanit.

Vlera totale për realizmin e projektit të lartëcekur është **65,860.00 EUR** (gjashtëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë euro).

Neni 2

Obligimet e palës së parë

Pala e parë Organizata “QATAR CHARITY” merr përsipër financimin e 90% të vlerës në emër të shpenzimit direkt për vlerën totale të realizimit të furnizimit dhe shpërndarjes së gjithësejt 60 – gjashtëdhjetë projekteve lartëcekura si dhe shpenzimeve të tjera të cilat ndërlidhen me realizmin e projektit me vlerë: **59,274.00 EUR** (pesëdhjetë e nëntëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër euro).

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

Pala e dytë, participon me pjesën prej 10% nga vlera e shpenzimit direkt (financimit të palës së parë), për vlerën totale të realizimit të furnizimit dhe shpërndarjes së gjithësejt 60 – gjashtëdhjetë projekteve lartëcekura si dhe shpenzimeve të tjera të cilat ndërlidhen me realizmin e projektit me vlerë: **6,586.00 EUR** (gjashtëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro).

Pala e dytë obligohet që brenda dy (2) javëve pas nënshkrimit të aneks marrëveshjes, këto mjete t'i transferojë në xhironlogarinë e Organizatës “Qatar Charity”, në Bankën NLB dhe numrin e llogarisë **1701001600054596**.

Kësaj aneks marrëveshje iu bashkëngjitet tabela e shpenzimeve e detajuar.

Ky aneks i marrëveshjes hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe i njëjti nënshkruhet në dy (2) kopje identike, prej të cilave secila palë mban nga një (1) kopje.


Nënshkruajnë:

Drejtore i organizatës "Qatar Charity"
z. Esam Dabab

Kryetar i Komunës së Lipjanit
z. Imri Ahmeti



قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office



REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E LIPJANIT
LIPJAN
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSO